



eptisa

PROJECT IMPLEMENTED BY JV NTU/EPTISA



FINANCED BY GOA AND COFINANCED BY WB



WORLD BANK GROUP

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Projekti i Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate

Hua e Bankës Botërore Nr. 8489-AL

Nr. i Kontratës: CS02

Shërbim Konsulence

për

Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore

Progres Raporti i Përkohshëm

Nr.6

Komponenti 4

D-4.6

Versioni Paraprak

Prill 2021



TË DHËNAT IDENTIFIKUESE TË PROJEKTIT

Emri i Projektit:	Shërbime Konsulence Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore - Projekti i Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate . (RRMSP)
Numri i References se Projektit :	WB2400-05/17, IBRD 84890TF 14761, P132982, CS 2, 8489 – AL
Vendi:	Shqiperi
Konsulenti:	JV NTU InternationalA/S / EPTISA Servicios De Ingenieria S.L.
Adresa:	Vestre Havnepromenade 5, 4. Floor DK-9000 Aalborg Danimarkë
Telefoni:	+45 99 30 0000
Faksi:	+45 99 30 0001
Person Kontakti:	Dritan Dibra –Drejtues Projekti, EPTISA
E-mail:	ddibra@eptisa.com
Data e Raportit:	Prill 2021
Autoret e raportit:	Gela Kvashilava, K-8 Specialist Komunikimi Jonela Sufaru, KN-9 Specialist Survejimi në komunitet <i>Me kontributin e :</i> <i>Stelios Efstathiadis, K-1 Specialist ne Menexhimin e Sigurisë Rrugore–Drejtues i Grupit të të Eksperteve</i>

SQARIM

Ky raport (duke përfshirë çdo shtojcë dhe dokument të bashkëlidhur) është përgatitur për përdorim ekskluziv dhe perfitim të Qeverisë së Shqipërisë/ Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Bankes Botërore, dhe vetëm për qëllimin për të cilin është përgatitur. Asnjë pjesë e këtij raporti nuk duhet të riprodhohet, shpërndahet apo t'i komunikohet një pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të JVNTU/EPTISA. JVNTU/ EPTISA nuk pranon asnjë përgjegjësi nëse ky raport përdoret për qëllim tjetër nga ai për të cilin është menduar, as nga palë të treta.

KONTROLI I DOKUMENTIT

Numri i References se Projektit:	WB2400-05/17, IBRD 84890TF 14761, P132982, CS 2, 8489 – AL Shërbime Konsulencë Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore- Projekti i Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate. (RRMSP)
Vendi	Shqipëri
Data	30.04.2021
Versioni	N°01

Versioni	Data	Pergatitur nga	Rishikuar nga
N°01	30.04.2021	Gela Kvashilava	Dragan Kostadinov Drejtues Projekti

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport është Progres Raporti i 6-të i Përkohshëm, e Komponentit 4 që përfshin "Fushatat publicitare dhe ndërgjegjësuere që targetojnë sjelljet jo të sigurta" për periudhën Shkurt-Prill 2021.

Qëllimi i këtij komponenti është të mbështesë futjen dhe vlerësimin e fushatave publicitare dhe ndërgjegjësimit që mbështesin aktivitetet e IMRSC dhe programet e zbatimit të policisë rrugore që shënjestrojnë sjelljet e pasigurta në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë si dhe të trajnoj stafin e MoIE (Zyra Drejtuese), ARRSH-së dhe policinë rrugore, por edhe organizata të tjera qeveritare (Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, etj.) si dhe konsulentët kombëtarë që kanë lidhje (të cilët mund të përfshijnë përfaqësues të sektorëve privatë), gazetarë në zbatimin dhe menaxhimin e fushatave të publicitetit dhe ndërgjegjësimit që mbështesin programet e zbatimit të policisë rrugore duke synuar sjelljet e pasigurta në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë.

Ky raport fokusohet në aspektet e: Aktivitetit 4.1 përgatitja e fushatave vjetore të publicitetit dhe ndërgjegjësimit në mbështetje të IMRSC, përfshirë këtu programet zbatuese të policisë që shënjestrojnë sjelljet e pasigurta në korridoret rrugore dhe zonat me rrezikshmëri të lartë; Aktiviteti 4.2 të trajnoj palët e interesit në dizejnimin dhe implementimin e fushatave vjetore publicitare dhe ndërgjegjësuere në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë.

Në veçanti, raporti mbulon detyrat e mëposhtme të: 4.1.7: Organizimi dhe mbajtja e konferencës si dhe Detyra 4.2.2: mbi trajnimin-në-punë, për zbatimin e fushatës publicitare dhe ndërgjegjësimit.

Raporti aktual është një pasqyrë e progresit të deri tanishëm dhe zhvillimeve të ardhshme.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Historiku i Projektit	Error! Bookmark not defined.
2. Progresi: Shkurt 2021 – Prill 2021	10
2.1 Hyrja.....	Error! Bookmark not defined.
2.2 Aktivitetet/Detyrat e realizuara.....	11
2.2.1 Konferenca finale për shtyp duke prezantuar arritjet e Projektit...	Error! Bookmark not defined.
2.2.2 Trajnim gjatë punës për zbatimin e fushatës publicitare dhe ndërgjegjësimit	Error! Bookmark not defined.
3. Tre-mujori i ardhshëm	Error! Bookmark not defined.
3.1 Plani i Punës	Error! Bookmark not defined.
3.2 Pasqyra e Aktivitetit dhe Detyrave	Error! Bookmark not defined.
SHTOJCA 1 Raport mbi konferencën për shtyp në të cilën prezantohen arritjet e fushatës publicitare dhe së ndërgjegjësimit	
SHTOJCA 2 Trajnim gjatë punës për zbatimin e fushatës publicitare dhe ndërgjegjësimit	

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Plan Pune Shkurt 2021 – Prill 2021	11
Tabela 2. Plan Pune Maj 2021 – Korrik 2021.....	14

LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE

AADT	Trafiku Mesatar Ditor Vjetor
ADF	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
ANPR	Njohja e Automatizuar e Targave
ARA	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ARC	Kodi Rrugor Shqiptar
ARDCS	Standartet e Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugeve
ARDM	Manuali i Projektimit të Rrugeve
ASP	Policia e Shtetit Shqiptar
ATC	Matje Automatike e Trafikut
ATP	Policia Shqiptare e Trafikut
BSM	Menaxhimi i Pikave të Zeza
CBMIE	Departamenti Drejtues në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
CSG	Grupi Drejtues Qendror
DRST	Drejtoria e Trafikut dhe Sigurisë Rrugore
DRST	
EC	Komisioni Europian
EG	Grupi i Eksperteve në nivel lokal
EU	Bashkimi Europian
GoA	Qeveria e Shqipërisë
GRD	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
ICRS	Komiteti Ndër-Ministror për Sigurinë Rrugore
IMRSC	Komiteti Ndër-Ministror i Sigurisë Rrugore
INSTAT	Instituti i Statistikave
IoT	Instituti i Transporteve
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit
iRAP	Programi Ndërkombëtar i Vlerësimit të Rrugëve
ITS	Sistemi Inteligent i Trafikut
JV	Sipërmarrje e Përbashkët
M&E	Monitorimi dhe Vlerësimi
MI	Ministria e Brendshme
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MoTI	Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës
NSM	Menaxhimi i Sigurisë së Rrjetit
PAMECA	Misioni i Komunitetit Europian i Ndihmës Policore për Shqipëri
PIARC	Shoqata Ndërkombëtare e Rrugeve
QKUM	Qendra Kombëtare e Emergjencës Mjekësore
RRMSP	Projekti i Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate
RSA	Auditimi i Sigurisë Rrugore
RSAIU	Njesia e Auditimit dhe Inspektimit të Sigurisë Rrugore
RSI	Inspektimi i Sigurisë Rrugore
RSIA	Vlerësimi i Impaktit të Sigurisë Rrugore
RSM	Menaxhimi i Sigurisë Rrugore
RSS	Spektori i Sigurisë Rrugore
SEETO	Observatori i Transportit të Europës Jug-Lindore

TA	Asistence Teknike
TERN	Rrjeti Rrugor TransEuropean
ToR	Termet e Referencës
TS	Sekretariati Teknik
WB	Banka Botërore
WHO	Organizata Botërore e Shëndetësisë

1. Historiku I Projektit

Projekti i Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore i Bazuar në Rezultatet (RRMSP) është një iniciativë e ndërmarrë nga Qeveria e Shqipërisë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar, me mbështetjen e Bankës Botërore. Projekti synon të ruajë kushtet dhe të përmirësojë sigurinë e Rrugëve Kryesore dhe Rrugëve Kryesore-Sekondare të Shqipërisë, duke forcuar praktikën dhe qëndrueshmërinë dhe efikasitetin të menaxhimit të asetëve rrugore dhe të sigurisë, për të mirën e përdoruesve të rrugës. RRMSP adreson çështjet e sigurisë rrugore përmes tre kanaleve të ndryshme: punët e mirëmbajtjes dhe përmirësimit të sigurisë; reformat institucionale dhe reformat sektoriale. Brenda fushëveprimit të RRMSP, ARRSH ka angazhuar shërbime konsulente për Asistencën Teknike të Sigurisë Rrugore (projekti aktual), të cilat sigurohen nga JV NTU / Eptisa (këtu e tutje referuar si Konsulent).

Projekti përbëhet nga 4 objektiva kryesore nën RRMSP, të cilat përfshijnë: (1) Fuqizimin e departamentit të sigurisë rrugore pranë MIE si zyrë kryesore; (2) Sigurimin e asistencës teknike në infrastrukturën për sigurinë rrugore; (3) Vendosja e një Sistemi Monitorimi dhe Vlerësimi të Qendrueshëm; dhe (4) Të përshkruajnë dhe të prioritojnë sjelljet e pasigurta në rrugët e Shqipërisë me fushata të propozuara ndërgjegjësimi, të udhëhequra nga kategoritë e synuara: Për “Promovimin” – e Fushatave Publicitare dhe të Ndërgjegjësimit që synojnë sjelljet e Pasigurta.

Komponenti 4, të cilit i referohet ky raport, ka katër aktivitetet kryesore vijuese, secila duke përfshirë nën-aktivitetet specifike që duhet të zbatohen. Katër aktivitetet kryesore janë si më poshtë:

- Përgatitja e fushatave vjetore publicitare dhe ndërgjegjësimi për të mbështetur IMRSC duke përfshirë programet e zbatimit të policisë rrugore që synojnë sjellje të pasigurta në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë (Aktiviteti 4.1);
- Trajnimi i stafit të MIE, ARRSH, Policisë Rrugore si dhe autoriteteve të tjera qeveritare apo OJF-ve në hartimin dhe zbatimin e fushatave vjetore publicitare dhe ndërgjegjësimi në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë (Aktiviteti 4.2);
- Vlerësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të fushatave publicitare dhe ndërgjegjësimi (Activity 4.3);
- Përgatitja e një fushate publicitare dhe ndërgjegjësimi pas-projekti (kombëtar) dhe udhëzime për të mbështetur programet e zbatimit të policisë rrugore që synojnë sjelljet e pasigurta në të gjithë rrjetin rrugor (Aktiviteti 4.4).

Objektivat e Fushatave Publicitare dhe Ndërgjegjësimi që synojnë sjelljet e pasigurta janë si më poshtë:

- Të mbështesi prezantimin dhe vlerësimin e fushatave publicitare dhe ndërgjegjësuere në mbështetje të aktiviteteve të IMRSC dhe programeve të zbatimit të policisë rrugore që synojnë sjelljet e pasigurta në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë.
- Të trajtojë stafin e MIE ((Zyra Kryesore), ARRSH dhe stafin e policisë rrugore dhe të organizatave të tjera qeveritare (Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, etj.), si dhe këshilltarët kombëtarë të përfshirë (të cilët mund të jenë përfaqësues të sektorëve privatë), gazetarë në zbatimin dhe menaxhimin e fushatave të publicitare dhe ndërgjegjësimi, që mbështesin programet e zbatimit të policisë rrugore të clat shënjestrojnë sjelljet e pasigurta në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë.

lartë. Përfshirja e sektorit privat mund të rezultojë fitimprurëse në qëndrueshmërinë e projektit në fazën pas përfundimit, në mënyrë që sektori privat të mund të marrë pjesë në financimin e fushatave (d.m.th. kompanitë e sigurimeve, Automobile Club Albania, kompanitë e naftës, etj.).

Përgatitja dhe këshilloni (duke ofruar trajnim në vendin e punës) në zbatimin e fushatave të synuara për përdoruesit e rrugës, duke mbuluar zhvillimin e strategjisë, krijimin e mesazheve, prodhimin e materialeve të fushatës si dhe planin dhe blerjen e hapsirës mediatike, që synojnë të ndryshojnë sjelljet shkatërruese të përdoruesve të rrugës.

- Vlerësoni efikasitetin dhe efektivitetin e fushatave publicitare dhe ndërgjegjësimit që mbështesin zbatimin e policisë rrugore duke synuar sjellje të pasigurta në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë.
- Mbështesni përgatitjen e një fushate (kombëtare) publicitare dhe ndërgjegjësimi pas-projekti, që mbështet programet e zbatimit të policisë rrugore të cilat shënjestrojnë sjelljet e pasigurta në të gjithë rrjetin rrugor, bazuar në përvojën e suksesshme në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë.

2. Progresi: Shkurt 2021 – Prill 2021

2.1 Hyrja

Aktiviteti i parë i Komponentit 4 "Përgatitja e fushatave vjetore publicitare të ndërgjegjësimit për të mbështetur IMRSC duke përfshirë programet e zbatimit të policisë rrugore që shënjestrojnë sjellje të pasigurta në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë", synon krijimin e fushatave publicitare dhe ndërgjegjësuere që mbështesin programet e zbatimit të IMRSC dhe policisë, duke shënjestruar sjelljet e pasigurta në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë.

Për të arritur objektivin e lartpërmendur, janë hartuar aktivitetet e mëposhtme:

- Kryerja e hulumtimeve për të identifikuar dhe dhënë përparësi sjelljeve me rrezikshmëri të lartë (Detyra 4.1.1a dhe Detyra 4.1.1b);
- Zhvillimi i qasjes ndaj fushatave publicitare dhe ndërgjegjësuere (Detyra 4.1.2);
- Identifikoni mjetet elektronike, sociale, mediat e shkruara dhe reklammat (Detyra 4.1.3);
- Propozoni logon dhe moton si e ashtuquajtura markë ombrellë për përdorim të ndryshëm (Detyra 4.1.4);
- Përgatitja e programit vjetor për caktimin e fushatave publicitare dhe ndërgjegjësuere (Detyra 4.1.5);
- Ndërtoni kapacitetet e palëve të interesuara për kryerjen e fushatave mediatike në qarkullim (Detyra 4.1.6a dhe Detyra 4.1.6b);
- Organizoni dhe mbani konferenca për shtyp (Detyra 4.1.7);

Ky dokument përmban rezultatet në lidhje me Detyrën 4.1.7: Organizoni dhe mbani konferencat përfundimtare për shtyp për të promovuar sigurinë rrugore.

Objekti kryesor i aktivitetit të dytë është trajnimi i stafit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ARRSH-së, stafit të policisë rrugore dhe autoriteteve të tjera qeveritare (Shëndetësia, Arsimi, etj.) ose të OJQ-ve në hartimin dhe zbatimin e fushatave vjetore publicitare dhe ndërgjegjësuere në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë.

Për të arritur objektivin e lartpërmendur, janë hartuar aktivitetet e mëposhtme:

- Përgatitja dhe ofrimi i programeve trajnuese që adresojnë parimet dhe praktikën e fushatave efektive publicitare dhe ndërgjegjësuere (Detyra 4.2.1a and Detyra 4.2.1b)
- Trajnim në-punë, për implementimin e fushatës publicitare dhe ndërgjegjësuere (Detyra 4.2.2)

Ky dokument përmban rezultatet në lidhje me Detyrën 4.2.2: Trajnim gjatë punës për zbatimin e fushatës publicitare dhe ndërgjegjësuere.

2.2 Aktivitetet/Detyrat e Realizuara

Sipas planit të punës, gjatë këtij tremujori janë kryer aktivitete të paraqitura në Tabelën 1.

Tabela 1. Plan Pune Shkurt 2021 – Prill 2021

Komponenti / Aktiviteti / Detyra	2021		
	Shkurt	Mars	Prill
Komponenti 4 – Mbi “Promovimin”– e Fushatës Publicitare dhe Ndërgjegjësuere e cila Shënjestron Sjelljet e Pasigurta			
Komponenti 4 –Progres Raporti I Përkohshëm			
4.1 Përgatitni fushatë vjetore Publicitare dhe Ndërgjegjësuere për të mbështetur IMRSC			
4.1.7 Organizoni dhe mbani konferenca për shtyp për të promovuar sigurinë rrugore			X
4.2 Trajtoni stafin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ARRSH-së, stafin e policisë etj.			
4.2.2 Raport mbi Trajnimin-në-punë mbi fushatat Publicitare dhe Ndërgjegjësuere			X

Qëllimi kryesor i Detyrës 4.1.7 ishte prezantimi i rezultateve të projektit. Në mënyrë që konferencat për shtyp të jenë më efektive për sa i përket dukshmërisë dhe shtrirjes në publik, konferencat për shtyp u mbajtën në mjediset e palëve përkatëse të sigurisë rrugore (të tilla si: MIE; Policia Rrugore, ARRSH etj.).

Për qëllim të rritjes së kapacitetit të palëve të interesuara për të kryer fushata publicitare dhe ndërgjegjësuere, Konsulenti ofroi trajnim dhe ndihmë gjatë punës brenda Detyrës 4.2.2.

2.2.1 Konferenca përfundimtare për shtyp që paraqet arritjet e Projektit

Për shkak të kufizimeve të paraqitura nga pandemia COVID-19, konferenca për shtyp u mbajt në 25 Shkurt 2021 përmes platformës Zoom.

Megjithëse aktualisht, fokusi kryesor i të gjitha autoriteteve në të gjithë botën fokusohen në çështje shëndetësore si dhe në zgjidhjen e efekteve ekonomike të shkaktuara nga pandemia, në konferencën për shtyp morën pjesë anëtarët e Komitetit Drejtues si dhe disa përfaqësues të mediave masive.

Së pari, Drejtuesi i Ekipit të Projektit paraqiti vërejtjet e tij mbi gjendjen e Projektit dhe qëllimin e Konferencës për Shtyp.

Pastaj eksperti ndërkombëtar Konsulent I Survejimit në Komunitet prezantoi temat e mbuluara nën Konferencën për shtyp dhe arritjet kryesore të projektit sipas Komponentit.

Prezantimi u përqendrua kryesisht në Komponentin 4 - Për "Promovimin" – e Fushatave Publicitare dhe Ndërgjegjësuese që shënjestrojnë Sjelljet e Pasigurta, duke prezantuar:

- Grupi i synuar, i përzgjedhur në bazë të hulumtimeve cilësore dhe sasiore, për t'u arritur nga fushata e ndërgjegjësimit për sigurinë rrugore;
- Logoja dhe motoja e propozuar për fushatën e ndërgjegjësimit, e zgjedhur pas hulumtimeve sasiore dhe sasiore midis grupit të synuar;
- Statistikat zyrtare në lidhje me evolucionin e sjelljes së shoferëve dhe shkaktimin e aksidenteve fatale dhe të rënda në rrugë;
- Vlerësimi i efikasitetit të iniciativave të sigurisë rrugore të ndërmarra në fund të vitit 2019 - fillim të vitit 2020 në Shqipëri.

Konferenca për shtyp zgjati rreth 40 minuta dhe u regjistrua me qëllim përhapjen dhe publikimin e saj nëpërmes faqes në internet të Projektit.

Për më tepër, Konferenca për shtyp u regjistrua e plotë dhe do të ngarkohet në faqen e internetit të Projektit (<https://roadsafety.al>) nën menunë multimedia. Në përgjithësi, 3 artikuj në internet u botuan bazuar në konferencën për shtyp. Të gjitha lajmet raportuan tërësisht njoftimin për shtyp dhe infografikun, duke nënvizuar në titull faktorët kryesorë të aksidenteve rrugore

2.2.2 Trajnimi gjatë punës mbi zbatimin e fushatës publicitare dhe ndërgjegjësuese

Ndërsa virusi i ri Coronavirus përhapet globalisht, trajnimi i planifikuar ballë-për-ballë u shndërrua në një format online.

Trajnimi u nda në tre-seanca:

- ✓ Seanca 1: Kryerja e sondazheve për identifikimin e sjelljeve me rrezikshmëri të lartë të përdoruesve të rrugës dhe vlerësimin e efikasitetit të një fushate ndërgjegjësimit
- ✓ Seanca 2: Hartimi i Fushatës Publicitare dhe Ndërgjegjësuese të Sigurisë Rrugore
- ✓ Seanca 3: Praktikat më të mira nga vendet e tjera lidhur me fushatat e Publicitare dhe Ndërgjegjësuese

Projekti mbledhi aktorët përkatës dhe i përgatiti ata për hartimin dhe zbatimin e fushatave vjetore Publicitare dhe ndërgjegjësuere në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë. Përfaqësuesit e organizatave përkatëse të interesuara në çështjet e sigurisë rrugore në Shqipëri ishin të përfshirë në trajnimet për hartimin dhe zbatimin e fushatave vjetore Publicitare dhe Ndërgjegjësuere në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë / Drejtoria e Shërbimeve të Transportit; Autoriteti Rrugor Shqiptar; Ministria e Brendshme / Drejtoria për Autoritetet Lokale (përfshirë bashkitë përkatëse, p.sh. Bashkia e Tiranës); Policia Rrugore Shqiptare; Instituti i Transportit; Ministria e Arsimit; Shërbimi i Urgjencës Shqiptare; Ministria e Shëndetësisë; Gazetarë.

Është e rëndësishme që të gjithë aktorët që veprojnë për sigurinë rrugore në Shqipëri të kenë një nivel të lartë të njohurisë mbi çështjet e sigurisë rrugore. Materialet e trajnimit u përgatitën bazuar në analizën e situatës kombëtare dhe nevojat e palëve të interesit, gjetjet e hulumtimeve cilësore dhe sasore si dhe përvojën më të mirë ndërkombëtare.

Sesionet e trajnimit nën Komponentin 4 filluan në 8 Mars me sesionin e parë të trajnimit në lidhje me sondazhet, përkatësisht "Kryerja e sondazheve për identifikimin e sjelljeve me rrezikshmëri të lartë të përdoruesve të rrugës dhe vlerësimin e efikasitetit të një fushate ndërgjegjësimi". Duke pranuar faktin që shumica e pjesëmarrësve nuk do të angazhohen në kryerjen e sondazheve nga fillimi deri në fund, qëllimi i trajnimit ishte t'u siguronte pjesëmarrësve njohuritë themelore në lidhje me:

- ✓ si të lexojmë të dhënat e sondazheve - bazuar në përmasat e mostrës, intervalin e besimit dhe kufirin e gabimit dhe se çfarë përfundimesh të nxjerrim rreth shifrave,
- ✓ si të analizojmë të dhënat - çfarë paket analize mund të përdoret dhe çfarë mund të bëhet me ndihmën e burimeve më të disponueshme të analizës, p.sh. MS Excel,
- ✓ si të zgjedhim modelin e kampionimit dhe përmasat e mostrës,
- ✓ si të krijoni një pyetësor të sigurisë rrugore për të identifikuar sjelljet e gabuara
- ✓ dhe, në fund, të kemi njohuri për të zhvilluar një përmbledhje të shkurtër të sondazhit, kur është e nevojshme.

Sesioni i dytë i trajnimit në lidhje me fushatën publicitare dhe ndërgjegjësuere nën Komponentin 4 u zhvillua në 11 Mars - "Hartimi i Fushatës Publicitare dhe Ndërgjegjësuere e Sigurisë Rrugore".

Sesioni trajnues përmbante komponentët e mëposhtëm:

- ✓ Problemi Global i Sigurisë Rrugore
- ✓ Natyra e Faktorëve të Rrezikut të Sigurisë Rrugore
- ✓ Shifrat e Sigurisë Rrugore në Shqipëri
- ✓ Projektimi i Fushatave të Ndërgjegjësimit për Sigurinë Rrugore

Sesioni i tretë i trajnimit u zhvillua në 19 Mars - "Praktikat më të mira nga vendet e tjera në lidhje me fushatat Publicitare dhe Ndërgjegjësuere".

Në Sesionin trajnues u prezantuan:

- ✓ Mësime të rëndësishme që mund të nxirren nga vlerësimet e fushatave
- ✓ Praktikat më të mira nga vendet e tjera
- ✓ Media si një palë e interesuar për fushatën e Sigurisë Rrugore

- ✓ Qasja e Sistemit të Sigurt për Sigurinë Rrugore
- ✓ Lista e Kontrollit të Programit të Komunikimit të Fushatës
- ✓ Rast studimi 1 – Promovim-Nxitja e vënies së Rripit të Sigurimit
- ✓ Rast Studimi 2 – Fushatat e ndërgjegjësimit dhe edukimit të sigurisë rrugore në korridorin E-60 Tbilisi-Poti dhe në Vendbanimet përgjatë këtij Korridori në autostradë

3. Tre-mujori i ardhshëm

3.1 Plan Pune

Sipas Tabelës 2, aktiviteti tjetër që do të përfundojë gjatë Majit 2021 - Korrikut 2021 i referohet përgatitjes së një fushate publicitare dhe ndërgjegjësuere(kombëtar) post-projekti.

Tabela 2. Plan Pune Maj 2021 – Korrik 2021

Komponenti / Aktiviteti / Detyra		2021		
		Maj	Qershor	Korrik
		Muajt e Projektit		
Component4-On“Promotion”–PublicityandAwarenessCampaignsTargetingunsafe Behaviours				
	Komponenti 4 –Progres Raport i Përkohshëm			
4.3	Vlerësoni efikasitetin dhe efektivitetin e aktiviteteve të kryera nën Komponentin 4			
4.3.2	Jepni rekomandime për përmirësimet në fushatat Publicitare dhe ndërgjegjësuere			X
4.4	Përgatitni një fushatë publicitare dhe ndërgjegjësuere (kombëtar)post-projekti			
4.4.1	Fushata publicitare dhe ndërgjegjësuere në të gjithë rrjetin, Post-projektit			X
4.4.2	Udhëzime që detajojnë kërkesat për fushatat Publicitare dhe Ndërgjegjësuere			X

3.2 Pasqyrë e Aktivitetit dhe Detyrave

Aktiviteti 4.3: Vlerësoni efikasitetin dhe efektivitetin e aktiviteteve të kryera nën Komponentin e katërt

Objekivi i këtij aktiviteti është të vlerësojë efikasitetin dhe efektivitetin e fushatave Publicitare dhe Ndërgjegjësuere që mbështesin zbatimet e policisë rrugore duke synuar sjellje të pasigurta në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë.

Detyra 4.3.2: Jepni rekomandime mbi përmirësimet në fushatat publicitare dhe ndërgjegjësuere që mbështesin programet e zbatimit të policisë rrugore që synojnë sjellje të pasigurta

Bazuar në monitorimin dhe vlerësimin e fushatave publicitare dhe ndërgjegjësuere, Konsulenti do të jetë në gjendje të ofrojë rekomandime për përmirësimet në fushatat publicitare dhe ndërgjegjësuere që mbështesin programet e zbatimit të policisë rrugore që synojnë sjellje të pasigurta. Kjo detyrë është realizuar falë kriterëve dhe treguesve të "Këshillueshmërisë së fushatave të ardhshme" të cilat, siç u paraqitën në detyrën e mëparshme, masin shkallën në të cilën këshillohet të shtrihen fushatat publicitare dhe ndërgjegjësuere pas detyrës aktuale, dhe se si ato mund të përmirësohen.

Rekomandimet mund të kenë të bëjnë me elementë të ndryshëm siç janë mesazhet kryesore, grupet e synuara, mjetet, orarin e zbatimit, përdorimin e ofruesve, etj.

Aktiviteti 4.4 Përgatitja e një fushate publiciteti dhe ndërgjegjësimi pas-projekti (kombëtar) dhe udhëzues për të mbështetur programet e zbatimit të policisë rrugore që synojnë sjelljet e pasigurta në të gjithë rrjetin

Objekti i këtij aktiviteti është të përgatisë një fushatë publicitare dhe ndërgjegjësuere (kombëtare) post-projekti, dhe udhëzime për të mbështetur programet e zbatimit të policisë rrugore që synojnë sjelljet e pasigurta në të gjithë rrjetin, bazuar në përvojën e suksesshme në korridoret dhe zonat me rrezikshmëri të lartë.

Detyra 4.4.1: Zhvilloni fushata publicitare dhe sensibilizuese pas- projektit, në të gjithë rrjetin, përfshirë vlerësimet e kostos së fushatës dhe orarin e zbatimit

Konsulenti do të sigurojë përgatitjen e një fushate publicitare dhe ndërgjegjësuere në të gjithë rrjetin pas-projektit, përfshirë vlerësimet e kostos së fushatës dhe orarin e zbatimit.

Fushatat e reklamimit dhe ndërgjegjësimit në të gjithë rrjetin pas-projektit do të përfshijnë, ndër të tjera:

- Qasjen e fushatave publicitare dhe ndërgjegjësuere (mesazhet kryesore, grupet e synuara, mjetet / veprimet, etj.)
- Vlerësimi i Kostos së fushatës
- Orari i Zbatimit
- Kërkesat për Trajnim

Detyra 4.4.2: Zhvilloni Udhëzime, duke përfshirë kërkesat për fushata publicitare dhe ndërgjegjësuere, që mbështesin programet e zbatimit të policisë rrugore që synojnë sjelljet e pasigurta në të gjithë rrjetin

Konsulenti do të zhvillojë udhëzime që detajojnë kërkesat për fushatat publicitare dhe ndërgjegjësuere që mbështesin programet e zbatimit të policisë rrugore që synojnë sjelljet e pasigurta në të gjithë rrjetin. Konsulenti do ta zhvillojë këtë mjet të jetë miqësor për përdoruesit, i cili do t'i shërbejë qëllimit të lehtësimit të përgatitjes dhe kryerjes së fushatave publicitare dhe ndërgjegjësuere në Shqipëri. Metodologjia e propozuar në udhëzim do të kombinojë praktikën më të mirë ndërkombëtare, teorinë mbi përpjekjet e komunikimit për ndryshimin e sjelljes dhe në marketingun shoqëror dhe mësimet e nxjerra nga fushata e zbatuar gjatë Projektit të Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore të bazuar në Rezultate (RRMSP).

Konsulenti do të përshkruajë veçanërisht kërkesat e ndryshme të nevojshme që synojnë nga kërkimi sasior dhe cilësor i sjelljeve të pasigurta në korridoret rrugore dhe zonat në Shqipëri, të cilat shërbejnë për monitorimin dhe vlerësimin e fushatave. Konsulenti do të sigurojë që kursi i veprimit për fushatat të paraqitet qartë dhe se në mënyrë plotësuese me programet e zbatimit të policisë rrugore, shënjestrimi i sjelljeve të pasigurta në të gjithë rrjetin është koherent.